

# Albania: Towards a More Effective Financing Mechanism for Regional Development | Drejt një mekanizmi më efektiv për financimin e zhvillimit rajonal në Shqipëri

Kejt Dhrami<sup>a</sup>, Anila Bejko (Gjika)<sup>b</sup>

## Summary

With the approval of the National Strategy for Development and Integration (NSDI) 2015-2020 in 2016<sup>1</sup>, Albania has made a significant step in establishing a proper legal/institutional framework for regional development (RD). There are, however, still important steps to be made before RD can work to reduce disparities in the territory and promote economic, social, and territorial cohesion. The legal framework on RD is not in place yet, and the institutional set up remains unclear. Four 'Regional Development Areas' have been designated and while they are not administrative divisions, their status is currently being discussed. The European Commission (EC) values the progress made so far by the Government of Albania (GoA) in terms of regional development and ranking policies as '*moderate*';

To date, only a few regional projects have been identified on the basis of national priorities, donor funding allocation, and other factors. The only mechanism for financing regional development in Albania has been the Regional Development Fund (RDF). This fund is allocated by line ministries on a yearly basis and finances projects according to an operational programme. The main problem with the RDF is a lack of vision and clear policy that guides investment and functions as a monitoring framework for guiding the interventions undertaken. In practice, some issues hamper the RDF to function as an effective mechanism to support development, such as: the unpredictability of investment priorities, political involvement in allocating investments, and the fragmentation of the funding into many small-scale<sup>2</sup> interventions.

The RDF has the potential of being developed and equipped with a programme-based approach and performance indicators to contribute to domestic regional development policy and complement EU support for regional development. So far, the system that has been established for the RDF is quite complex and is not yet compatible with EU-requirements in terms of both prior to and following the accession funds.

This contribution discusses the RDF by addressing the way it is distributed and which reforms are needed.

**Keywords:** Regional Development Fund, EU Regional Policy, Regional Disparities, Governance

## Contact | Kontakt

<sup>a</sup>kejt\_dhrami@co-plan.org (Corresponding author)

<sup>b</sup>anila\_gjika@co-plan.org

Co-PLAN, Institute for Habitat Development, Permanent Workshop on Territorial Governance  
POLIS University, Tiranë, Shqipëri, [www.co-plan.org](http://www.co-plan.org); [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

## Përmbledhje

Me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, SKZHI (2015-2020), në vitin 2016<sup>1</sup>, Shqipëria ka ndërmarrë një hap shumë domethënës për ngritjen e një kornize të qëndrueshme ligjore/institucionale për zhvillimin rajonal. Gjithsesi, nevojitet të hidhen disa hapa të tjerë të rëndësishëm, në mënyrë që zhvillimi rajonal të mund të adresojë realisht pabarazitë në territor e të promovojë kohezionin ekonomik, social e territorial. Korniza ligjore mbi ZHR-në nuk është ende e plotë, ndërkohë që organizimi institucional është gjithashtu i paqartë. Në kuadër të nismave për përshtatjen e ZHR-së ndaj Politikës së Kohezionit të BE-së, në vitin 2015 u përcaktuan katër Zona të Zhvillimit Rajonal. Këto janë ndarje territoriale joadministrative, por statusi i tyre është ende në diskutim. Ndërkaq, në Progres Raportin e vitit 2018, në Kapitullin 22, Komisioni Evropian e vlerëson ecurinë e Qeverisë Shqiptare në lidhje me zhvillimin e politikave rajonale si 'mesatare'.

Në fakt, në Shqipëri mund të identifikohet një numër mjaft i vogël projektesh *rajonale* me impakt në zhvillimin rajonal të cilat varen nga prioritetet kombëtare, nga mënyra si shpërndahen fondet e donatorëve etj. I vetmi mekanizëm që historikisht ka financuar (e vazhdon të financojë) zhvillimin rajonal në Shqipëri është Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Ky fond përcaktohet çdo vit nga ministritë e linjës dhe shpërndahet bazuar në programin operacional respektiv të përvitshëm. Problemi kryesor me FZHR-në qëndron në mungesën e një vizioni e politike të qartë që të orientojë investimet e të funksionojë si një kornizë monitoruese për ndërhyrjet e propozuara. Në praktikë, ka dy çështje kryesore që pengojnë funksionimin e tij si një mekanizëm efektiv për mbështetjen e zhvillimit rajonal: paparashikueshmëria e prioritetëve të investimeve dhe fragmentimi i fondit në shumë ndërhyrje të shkallës së vogël<sup>2</sup>.

Sigurisht, FZHR-ja ka potencialin për t'u zhvilluar sipas një qasjeje programimi, duke u pasuruar me tregues të performancës, në mënyrë që të kontribuojë në politikat e brendshme të zhvillimit rajonal dhe njëkohësisht të ecë paralel me Politikën e Kohezionit të BE-së. Gjithsesi, sistemi i caktuar për FZHR-në aktualisht është shumë kompleks e i papërshtatur me kërkesat e BE-së në kontekstin e fondeve të para e pas aderimit.

Ky artikull bën një diskutim në lidhje me FZHR-në, duke trajtuar disa aspekte të mënyrës së shpërndarjes së tij, dhe jep disa rekomandime mbi reformimin e nevojshëm.

**Fjalë kyçe:** Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, politikat rajonale të BE-së, pabarazitë rajonale, qeverisje

## Albania in the Context of Regional Development

Discussion of regional development in Albania started over a decade ago, in parallel with the process of decentralization and the territorial administrative reform. In 2015, concrete steps were undertaken by the government to establish regional bodies that would address regional development, and would be aligned with EU regional policy. The latter, known also as Cohesion Policy, aims to capitalize on the potentials of territories and their available resources, including

## Shqipëria në kontekstin e zhvillimit rajonal

Diskutimi mbi Zhvillimin Rajonal në Shqipëri ka nisur më shumë se një dekadë më parë, paralelisht me procesin e decentralizimit dhe reformën administrative-territoriale. Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare ndërmori disa hapa më konkretë duke ngritur trupat e parë funksionale në nivel rajoni, të cilët do të trajtonin zhvillimin rajonal në përputhje me politikën rajonale të BE-së. Kjo politikë, e njohur ndryshe si Politika e Kohezionit, ka synim të kapitalizojë mbi potencialet territoriale

EU pre-accession and post-accession funds. Within the established legal framework<sup>3</sup>, four regional development areas were designated and new institutional structures were formed, namely: the National Agency for Regional Development (NARD), four Regional Development Agencies (RDAs), and a Regional Economic Development Agency (REDA). While the four RDAs and REDA became operational by mid-2016, NARD has yet to become operational.

In July 2018, the DCM no. 961/2015 was repealed and the Albanian Development Fund (ADF)<sup>4</sup> became responsible for carrying out all of the functions of the above listed institutions. The main argument supporting the reform was to avoid possible overlaps of competencies between several bodies. The discussion now centres around the institutional set up and respective functions as part of the mechanism for implementation of the Regional Development policy in Albania. On the other hand, it is still unclear whether or not the Regional Development Areas designated in 2015 will be the territories where regional development policies will be implemented both in terms of domestic regional policy as well as regional and cohesion policy upon accession. Nevertheless, the structural mechanism for RD, coupled with the appropriate institutional setup, needs to be established and responsibility clarified for the implementation of regional policy post-accession, and, most importantly, for the implementation of national policies on regional development. This means that these institutions need to develop capacities in programming and management of structural and cohesion funds. Most importantly, there needs to be a backbone of financial support to address the internal disparities through regional development policy implementation and, more specifically, through the effective allocation of funds in the territory.

Though the Regional Development Fund in the last two years<sup>5</sup> has been considered as a financial mechanism similar to an operational programme, it does not represent yet a proper operational programme for RD policy implementation. An operational programme in the context of EU Cohesion Policy refers to a detailed plan, in which Member States set out how money from the European Structural and Investment Funds will

e burimet e disponueshme, përfshirë këtu edhe fondet e para e pasaderimit në BE. Korniza ligjore e ngritur<sup>3</sup> përcaktoi krijimin e 4 Zonave të Zhvillimit Rajonal si dhe themelimin e strukturave të reja institucionale si Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal, 4 Agjenci të Zhvillimit Rajonal (AZHR) dhe një Agjenci e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER). Ndërkohë që 4 AZHR-të dhe AZHER-i nisën të funksiononin që në gjysmën e parë të vitit 2016, AKZHR-ja nuk u themelua kurrë.

Në korrik 2018, VKM nr. 961/2015 u shfuqizua dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit<sup>4</sup> u bë përgjegjës për të mbartur gjithë funksionet e institucioneve të lartpërmendura. Argumentimi kryesor për këtë vendim ishte shmangia e mbivendosjeve të kompetencave mes institucioneve të ndryshme. Aktualisht është në diskutim e sipër skema institucionale që do të adresojë zhvillimin rajonal, së bashku me përgjegjësitë përkatëse të çdo institucioni në fjalë. Në vazhdim të këtyre zhvillimeve të reja, ende është e paqartë nëse Zonat e Zhvillimit Rajonal, të krijuara në 2015, do të jenë territoret ku do të zbatohet politika e zhvillimit rajonal. Në çdo rast, mekanizmi strukturor për ZHR-në, së bashku me skemën respektive institucionale, ka nevojë ende të qartësohet, për të mundësuar zbatimin e politikës së kohezionit pas anëtarësimit si dhe, më e rëndësishme, zbatimin e politikave kombëtare mbi zhvillimin rajonal. Kjo do të thotë që këto institucione duhet të zhvillojnë kapacitete në *programim* dhe në *menaxhimin e fondeve strukturore e të kohezionit*. Por, më e rëndësishme akoma është të krijohet baza për mbështetjen financiare, për të adresuar pabarazitë e brendshme nëpërmjet zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal, dhe, më specifikisht, nëpërmjet shpërndarjes efektive të fondeve në territor.

Pavarësisht se Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, gjatë 2 viteve të fundit<sup>5</sup>, është trajtuar si një mekanizëm financiar i ngjashëm me një program operacional, ai ende nuk përfaqëson një program operacional të mirëfilltë për zbatimin e politikave të ZHR-së. Një program operacional, në kuadër të Politikës së Kohezionit të BE-së, nënkupton një plan të detajuar në nivel prioritetesh e masash, ku vendet anëtare përcaktojnë se si do të shpenzohen fondet në dispozicion përgjatë periudhës së programimit dhe si do të ndodhë bashkëfinancimi përmes burimeve të brendshme (KE, 2014). Ky artikull

be spent during the programming period, and how co-financing will occur through domestic resources (EC, 2014). This article underlines the importance of modifying the mechanism behind the RDF, to have a well-defined instrument for the implementation of RD policy and measurable impacts on reduction of disparities in Albania.

## Albania and its Commitment to Cohesion Policy

From a European perspective, Regional/Cohesion Policy is the main investment policy that aims at 'reducing disparities between regions and encouraging development of less-developed regions'<sup>6</sup> (EC, 2014). In Europe, these disparities are increasingly relevant, with a GDP per capita in the poorest regions four times lower than that of the richest regions (EC, 2016). Of course, each Member State (MS) adopts their own targets to reach the desired outcomes of regional policy. The way such policies will be implemented and the mechanisms for channelling European funding, remain some of the most challenging issues to be addressed by the Albanian government, both prior to and following the accession to EU<sup>7</sup>.

The concept for regional development in Albania was a response to the necessity to have a coherent regional policy in line with the principles of the EU cohesion policy and in accordance with the third objective of NSDI, which underlines the importance of enabling and *creating competitive regions, and aiming a balanced and sustainable development of all regions through the reduction of development disparities between them*. According to the EU Progress Report 2018, Albania is still moderately prepared in the area of regional policy.

In broader terms, the implementation of Cohesion Policy in Member States is exclusively the competency of the respective central government. The directions/objectives and targets of regional policies are defined by each MS and thus their accountability to EU Commission extends only so far as to ensure that their established programming, financing, and monitoring mechanism is functional. Three key points are relevant for the preparation process for accession, according to the Progress Report with regards to regional development (Chapter 22): clarity in the

nënvizion rëndësinë e ndryshimit të mekanizmit të FZHR-së për të pasur një instrument të mirëpërcaktuar për zbatimin e politikave të ZHR-së dhe për të matur në mënyrë efektive ndikimin mbi reduktimin e pabarazive në Shqipëri.

## Shqipëria dhe angazhimi ndaj Politikës së Kohezionit

Në kontekstin Evropian, Politika e Kohezionit është politika kryesore që orienton investimet, duke u fokusuar në 'uljen e pabarazive mes rajoneve dhe inkurajimin e zhvillimit të rajoneve më pak të zhvilluara'<sup>6</sup> (KE, 2014). Këto pabarazi po bëhen gjithnjë e më të pranishme në Evropë, ku PBB për frymë në rajonet më të varfra është mbi 4 herë më i ulët se në rajonet më të pasura (KE, n.d.). Sigurisht, çdo vend anëtar përcakton objektivat e brendshme të politikës së kohezionit e treguesit respektivë të realizimit të tyre. Mënyra se si do të zbatohen këto politika dhe mekanizmat që do të shërbejnë për kanalizimin e fondeve Evropiane në vend janë dy nga çështjet më të rëndësishme për t'u adresuar nga Qeveria Shqiptare, si për fonde të paraaderimit ashtu edhe për fondet e disponueshme pas anëtarësimit në BE<sup>7</sup>.

Në Shqipëri, koncepti për zhvillimin rajonal erdhi si një përgjigje ndaj nevojës për të pasur një politikë koherente rajonale, të përputhur me parimet e politikës së kohezionit të BE-së, dhe në përmbushje të objektivit të tretë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), i cili thekson rëndësinë e krijimit të *rajoneve konkurruese*, me qëllim *zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të të gjithë rajoneve nëpërmjet reduktimit të pabarazive mes tyre*. Raporti i Progresit i BE-së për vitin 2018 përcakton se Shqipëria ka pasur ecuri 'mesatare' në çështjen e politikës rajonale.

Pra, zbatimi i Politikës së Kohezionit në vendet anëtare është kompetencë ekskluzive e Qeverive Qendrore respektive. Drejtimet/orientimet dhe treguesit për Politikën Rajonale përcaktohen nga secili vend anëtar e, si rrjedhojë, edhe llogaridhënia e tyre ndaj Komisionit Evropian shkon deri aty sa të sigurohet që ky mekanizëm i ngritur për programimin, financimin e monitorimin të jetë funksional. Çfarë është e rëndësishme në lidhje me zhvillimin rajonal (Kapitulli 22), sipas Raportit i Progresit, janë 3 pika kyçe: - të ketë qartësi mbi

way that national policies and objectives are set; establishment of a reliable institutional structure for RD implementation; and a clear operational programme for the financing of RD. These three points are imperative for the implementation of a sound RD reform, and the operational programme is considered as the most important instrument to operationalise the implementation of RD policy<sup>8</sup>.

## Disparities in Albania – a Short Overview with a Focus on Regional Development

As cohesion policy suggests, national policies supporting economic, social, and territorial cohesion, need to address disparities between and within regions in Albania (both between *Qarks*<sup>9</sup>, between LGUs, and between urban and rural areas). Though the process of designating Regional Development Areas<sup>10</sup> took into consideration some of these factors, namely: population, number of Qarks, GDP per capita, general economic profiles, among others; there are still several relevant factors that influence the widening of disparities and the need to implement realistic regional policies.

Studies on disparity in Albania<sup>11</sup> suggest that territorial disparities exist and are manifested in different ways at different levels, both among and within regions. Investments strategies and projects should be designed to reflect the different territorial levels and not only the four development regions. (Shutina, et al., 2015) Furthermore, the national development profile is monocentric, with most of the GDP, population, and accessibility of services and jobs concentrated in the Tirana-Durrës area. This national, monocentric development is further complemented by a recurrent pattern of population growth and concentration of economic activities in the same area (Shutina, et al., 2015). This, and many other indicators, suggest that disparities in Albania are present in all aspects (territorial, economic, and social) and at all levels (among regions, within regions, and among urban and rural areas). Disparities are especially high at the local level and among rural and urban areas. The large size and mixed territorial character of the regions 'hides' these lower level disparities. Steps are being taken to decrease them, but not in

mënyrën e caktimit të politikave kombëtare e objektivave të zhvillimit; - të përcaktohet një strukturë institucionale e përshtatshme për të zbatuar ZHR-në;- të hartohet një program operacional i qartë për financimin e ZHR-së. Këto tri çështje janë thelbësore për zbatimin e një reforme të suksesshme për ZHR-në dhe Programi Operacional konsiderohet si një ndër instrumentet më të rëndësishme për të vënë në zbatim këtë politikë<sup>8</sup>.

## Pabarazitë në Shqipëri – një këndvështrim i shkurtër me fokus në zhvillimin rajonal

Në përputhje me Politikën e Kohezionit, të gjitha politikat kombëtare që mbështetin kohezionin ekonomik, social e territorial në Shqipëri duhet të adresojnë pabarazitë mes rajoneve dhe ato brenda rajoneve (p.sh. mes qarqeve<sup>9</sup>, mes NJQV-ve dhe mes zonave urbane e rurale). Procesi i caktimit të Zonave të Zhvillimit Rajonal<sup>10</sup> mori në konsideratë disa prej këtyre faktorëve si popullsinë, numrin e qarqeve për rajon, profilin e përgjithshëm ekonomik etj. Pavarësisht kësaj, ka shumë faktorë që ndikojnë në rritjen e pabarazive dhe theksojnë nevojën për të zbatuar politika rajonale realiste.


Studimet mbi pabarazitë në Shqipëri<sup>11</sup> arrijnë në konkluzionin se, jo vetëm ka pabarazi territoriale në vend, por ato manifestohen në nivele të ndryshme, si mes rajoneve, ashtu edhe brenda tyre. Strategjitë e investimeve dhe projektet duhet të hartohen në mënyrë të tillë që t'i pasqyrojnë këto nivele territoriale e të mos fokusohen vetëm në 4 Rajonet Zhvillimore (Shutina, et al., 2015). Për më tepër, profili kombëtar i zhvillimit është mjaft monocentrik. Pjesa më e madhe e PBB-së, popullsisë dhe aksesit në shërbime e në vende pune është e përqendruar në zonën ekonomike Tiranë-Durrës. Ky zhvillim monocentrik theksohet më tepër edhe nga tendencat e vazhdueshme të rritjes së popullsisë e përqëndrimit të aktiviteteve ekonomike në të njëjtën zonë (Shutina, et al., 2015). Ka shumë tregues që sugjerojnë se pabarazitë në Shqipëri ekzistojnë në shumë aspekte (territoriale, ekonomike, sociale) dhe nivele (mes rajoneve, brenda rajoneve, urbane-rurale) dhe, pavarësisht se janë marrë masa për t'i adresuar ato, këto masa nuk kanë qenë të integruara. Figura 1 më poshtë



an integrated way. Figure 1 shows that *disparities within regions* in terms of GDP have decreased annually, but without a specific regional policy supporting them. While Region 2 has a higher GDP per capita throughout the whole study period, due to the Tirana-Durrës economic area in its territory, Region 4 shows improvement during 2010 – 2014 due to the increase in GDP per capita in the *Qark* of Fier.

tregon se *pabarazitë brenda rajoneve* në lidhje me PBB-në janë reduktuar vit pas viti, por pa ndonjë politikë rajonale që t'i mbështesë. Ndërkohë që Rajoni 2 shfaq tregues më të lartë të PBB-së për frymë përgjatë të gjithë periudhës kohore për shkak të pranisë së zonës ekonomike Tiranë-Durrës në të, Rajoni 4 shfaq tendenca përmirësimi mes viteve 2010 – 2014 për shkak të rritjes së indeksit të PBB-së për frymë në Qarkun Fier. Këto të dhëna theksojnë faktin se *pabarazitë mes rajoneve* në Shqipëri janë reduktuar, por ky proces nuk është orientuar në mënyrë specifike nga ndonjë politikë/strategji për zhvillimin rajonal deri tani.

**Figure 1 | Figura 1.** GDP per capita by Regions, indexes (Albania = 100%) | PBB për frymë sipas Rajoneve, e indeksuar (Shqipëria = 100)



**Source | Burimi:** Shutina et al. (2015), based on INSTAT data | Shutina et al. (2015), bazuar në të dhëna nga INSTAT

## An Overview of the Regional Development Fund – Current Policies

To date, the Regional Development Fund is the most relevant funding mechanism for capital investments in local and regional infrastructure. Since its creation in 2006, the RDF has been used as a competitive grant for investments at the local level, later re-introduced (in 2010) as a fundamental instrument for financing RD policy,<sup>12</sup> local development, and promoting territorial/economic cohesion. The RDF is designed as a pool of budget lines from different line ministries and institutions<sup>13</sup>, managed by the Committee on Regional Development (CRD) and coordinated by the general secretariat from one unit within the Prime Minister's Office (PMO). It is revised annually based on the annual budget law, and this makes it an unpredictable and unstable financial mechanism. For 2018<sup>14</sup>, the six compounding competitive grants of the RDF were:

1. Local and Regional Infrastructure,
2. Education,
3. Healthcare (provision of primary healthcare services),
4. Art and Culture,
5. Water Supply and Sewage,
6. Environmental rehabilitation, Greenery, and Forestation.

In the past few years, the RDF has been implemented through three pillars: (i) the Programme for Regional and Local Infrastructure (which contained the above mentioned areas of investment); (ii) the Programme for Supporting the Economy; and (iii) the Programme 'Digital Albania'. The focus of this instrument varies on a yearly basis in accordance with government priorities and the agendas of line ministries. The approach followed for the RDF has shifted from fulfilling the basic infrastructure needs of LGUs and promoting disadvantaged areas, to renovating main city squares and improving public spaces in the cities (for data on the volume of funding allocated to regional infrastructure, see Figure 2).

To date, the RDF is the only instrument to finance regional development in Albania, but the future for this instrument is still unclear. Currently the

## Një vështrim mbi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve – politikat aktuale

Deri më sot, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve është mekanizmi më i rëndësishëm për investime kapitale në infrastrukturën vendore e rajonale. Që prej themelimit të tij në 2006, FZHR-ja është përdorur si grant konkurrues për investimet në nivelin vendor, për t'u risjellë më pas (në 2010) si një instrument thelbësor për financimin e politikave të ZHR-së<sup>12</sup> dhe për zhvillimin vendor, duke promovuar kohezion ekonomik e territorial. FZHR-ja ka funksionuar si një përmbledhje linjash buxhetore nga Ministri të Linjës e institucione të ndryshme<sup>13</sup> dhe menaxhohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR) e koordinohet nga Sekretariati i Përgjithshëm, rolin e të cilit e luan një njësi e Zyrës së Kryeministrit. Fondi, si dhe mekanizmi i shpërndarjes së tij, rishikohet vit për vit bazuar në ligjin mbi buxhetin e shtetit, duke u bërë në këtë mënyrë një instrument financiar i paqëndrueshëm e i vështirë për t'u parashikuar. Për vitin 2018<sup>14</sup>, 6 fushat përbërëse të grantit konkurrues të FZHR-së ishin:

1. Infrastruktura vendore dhe rajonale,
2. Arsimi,
3. Shëndetësia (Sigurimi i shërbimeve të shëndetit primar),
4. Arti dhe Kultura,
5. Furnizimi me ujë e kanalizimet,
6. Rehabilitimi mjedisor, gjelbërimi dhe pyllëzimi.

Gjatë viteve të fundit, FZHR-ja është zbatuar përmes 3 shtyllave kryesore, respektivisht: (i) Programi për Infrastrukturën Rajonale e Vendore (i cili përmbante fushat e përmendura më sipër); (ii) Programi për Mbështetjen e Ekonomisë; (iii) Programi 'Shqipëria Dixhitale'. Në fakt, fokusi i këtij instrumenti ka ndryshuar vit pas viti, sipas prioriteteve të qeverisë dhe agjendave të Ministrive të Linjës. Ndërhyrjet e zbatuara përmes FZHR-së kanë ndryshuar nga përmbushja e nevojave infrastrukturore bazë të NJQV-ve dhe promovimit të zonave të dizavantazuara, në rinovimin e shesheve qendrore urbane dhe përmirësimit të hapësirave publike në qytete (Shih Figurën 2 për të dhëna mbi vëllimin e financimit të dedikuar infrastrukturave rajonale).

GoA is supported by the Swiss government and the Austrian government to implement the third phase of the Regional Development Programme Albania (RDPA), implemented by Ecorys and Co-PLAN. Within RDPA, detailed guidelines for the preparation of an Operational Programme for Financing of Regional Development (OPFRD) in Albania are prepared.

The OPFRD is designed in line with other proposed national and regional documents for regional development, foreseen to be implemented over multi-annual framework (possibly in coherence with the EU Cohesion Policy timeline). It proposes a detailed implementation system, which takes its main input from the strategic objectives and priorities of RD and addresses the following issues (among others): (1) an analysis of the coherence with domestic policies and community policies; (2) a detailed financial plan and an indicative budget allocation; (3) an implementation system, comprised of the management system, monitoring and evaluation system, and financial management and control system, among others; (4) an operational programme, which specifies the list of operations and the indicated measures; and finally (5) and ex-ante evaluation of the impact of the OPFRD (RDPA, 2017).

## **RDF Mechanisms and Links to the Decentralization Process and Regional Disparities**

When it comes to the RDF's contribution to national GDP and local investments, there is very little data available to monitor and evaluate its impact. This is first due to the fact that the RDF as a financial mechanism has changed over the years. It was introduced in 2006 as a competitive grant system for capital investments at the local government level. In 2010, it was transformed into a regional development fund. From its inception, the RDF was created as a pool of budget lines from different line ministries and managed as such. The part of the RDF dedicated to local infrastructure in the form of unconditional transfers to local governments still constitutes the core of the RDF today. Since 2014, this part of the RDF has been covered through the budget line of the Ministry of Urban Development and latter ADF, which have

